



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2442/4 prot.

Datë 30.10.2023

V E N D I M

Nr. 1093/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. *REF- 77564-08-16-2023*, me objekt “Blerje rroba pune” me fond limit 13,290,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A.

Ankimues:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Alb Gerald 2023” SHPK me NIPT M31910029T & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” me NIPT 7420380362
Rruga “Ramadan Sokoli”, Godina 36, Laprakë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A
Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës Km.

9

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17-08-2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF- 77564-08-16-2023, me objekt “Blerje rroba pune” me fond limit 13,290,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 01.09.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 28.09.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Univers Promotions”SHPK	10.464.000.00lekë	skualifikuar
2. “Malbertex” SHPK	12.726.200.00lekë	skualifikuar
3. “Alb-Gerald 2023” SHPK	12,999,969.00 lekë	skualifikuar

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi rezulton i skualifikuar për arsye se:

• *Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi BOE nuk ka paraqitur vërtetim të xhiros vjetore për vitet e kërkuara. Vërtetimi i vetëm i paraqitur nga OE “ALB-GERALD 2023” sh.p.k., nuk arrin vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit.*

II.4 Në datën 29.09.2023 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 05.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2442 protokollit e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi”, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2442/2 Prot., datë 06.10.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 5116/4 prot, datë 06.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2442/3 prot., datë 10.10.2023 me lëndë: “Dërgohet vendim i arsyetuar”, autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr, 5116/3 prot., datë 09.10.2023, mbi shqyrtimin e ankesës së Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi”, ku ka vendosur mospranimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues duke argumentuar se; “[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton si më poshtë: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me pretendimet e

mësipërme të OE ankimues, iu referua ankesës së operatorit ekonomik, dokumenteve të tenderit të hartuara nga NJP, si dhe vlerësimin të dokumenteve të tenderit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ku pasi i shqyrtoi ato me imtësi arriti në konkluzionin si më poshtë vijon:

Procedura e prokurimit me objekt “Blerje rroba pune” është hartuar dhe publikuar nga OST sh.a në bazë të ligjit nr. 162/ datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pas shqyrtimit të dokumentit me emërtimin “vërtetim_tatim_taksash_xhiro_3_vite”, cituar në ankim nga OE ankimues, KSHA çmon se në të pasqyrohen vlera të operatorit ekonomik turk, pjesë të BOE, por nuk dëshmohet nëse këto vlera janë në monedhën vendase ku ushtron aktivitetin tregtar OE i huaj, apo në ndonjë monedhë tjetër.

Në këto kushte, vendimi i KVO çmohet i drejtë, pasi nuk është në gjendje të nxjerrë një vlerë të saktë të xhiros vjetor të OE të huaj dhe në këtë mënyrë të vërtetohet se përmbushet pika 2.2.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Si përfundim, gjykojmë refuzimin e ankesës.

Për sa parashtruar më sipër, mbështetur në pikën 3/c të nenit 114, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 1/c të nenit 102 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

VENDOSI:

- 1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga BOE “Alb Gerald 2023” shpk & “Samteks Makina, Insaat, taahhut, Tekstil, Imalat Sanayi Ticaret Ltd Sirketinn [...]”.*

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” se: “Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi BOE nuk ka paraqitur vërtetim të xhiros vjetore për vitet e kërkuara. Vërtetimi i vetëm i paraqitur

nga OE "ALB-GERALD 2023" sh.p.k., nuk arrin vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në dokumentet standarde të tenderit shtojca 7, Kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.2.1 përcaktohet që:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 13,000,000 (trembëdhjetë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpërmendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.1.2 Referuar sistemit elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim_tatim_taksash_xhiro_3_vite pdf të përkthyer dhe noterizuar
- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T08941760, datë 31.08.2023

III.1.3 Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues me arsyen, se *Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi BOE nuk ka paraqitur vërtetim të xhiros vjetore për vitet e kërkuara. Vërtetimi i vetëm i paraqitur nga OE “ALB-GERALD 2023” sh.p.k., nuk arrin vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar ku parashikohet se: “ *Komisioni i vlerësimit*

të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor nëse kishte dyshime, apo pamundësi për të verifikuar dokumentin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatori ekonomik ankimues me emërtimin vërtetim_tatim_taksash_xhiro_3_vite, duhet t’i kërkonte sqarime BOE “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi.

Akoma më tej në bazë të nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ndaj, në kushtet kur dokumentacioni i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” i nënshtrohet ligjit të një shteti të huaj, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkonte informacion mbi rregullimin ligjor të Republikës së Turqisë, lidhur me vërtetimin e xhiros të paraqitur nga operatori ekonomik.

Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi” ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt – ankimi, duke paraqitur vërtetim tatim – taksash, xhiro e 3 viteve, të lëshuara nga organet tatimore të Republikës së Turqisë, si rrjedhojë dokumentacioni i dorëzuar nga kjo shoqëri i nënshtrohet legjisllacionit Turk.

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kualifikojë bashkimin e operatorëve ekonomikë “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi, si dhe t’i kërkojë sqarime lidhur me vërtetimin e xhiros të paraqitur nga shoqëria Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF- 77564-08-16-2023, me objekt “Blerje rroba pune” me fond limit 13,290,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi, dhe të korrigjojë shkeljet sipas konstatimeve të KPP-së.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Alb Gerald 2023” SHPK & “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, tekstil, Imalat Sanayi ticaret LTD Sirketi”.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri